REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI

Nr/Br. 156/17
Datë/Datum. 25-05-2017

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: KUVENDI KOMUNAL MITROVICË

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: 642 – 17 – 659 – 2-1-1

642/17/011/211

Sa i përket tenderit për : Hartimi dhe Mbikëqyrja e Projekteve për Investime Kapitale-2 Llote

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

NPN "Euro Projekt Plus"

RR. 11 Mars1 1981

Mitrovicë 40000

[redacted]

Xhemshir Mulliqi

[redacted]

24.05.2017

Nënshkrimi

vula

N.P.N. "Euro Projekt Plus" - Mitrovicë - Kosovë

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Autoriteti kontraktues i Kuvendit komunal te Mitrovicës ka bere shkelje te -
Neni 7 Barazia në Trajtim / **Jo-Diskriminimi** pasi gjate vlerësimit nuk i ka trajtuar te gjithë njësoj e ne baze te kësaj mundem te konstatojmë se ka bere shkelur konkurrencën ne mes te OE dhe ka favorizuar OE te rekomanduar per kontrate .

Autoriteti kontraktues i Kuvendit komunal te Mitrovicës ka bere shkelje te -
nenit 59 te ligjit 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L 092 pasi nuk ka bere vlerësim objektiv ne përputhje me nenin 59.4 pasi Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit .

Autoriteti kontraktues i Kuvendit komunal te Mitrovicës ka bere shkelje te -
nenin 59 pika 2 pasi autoriteti kontraktues i mundet që me shkrim të kërkojë nga një OE që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve ne ketë raste ka mundur te kërkoj sqarime per te gjitha kontratat dhe referencat me BP Home, kontrata me Komunën e Skenderajt qe dorëzuar Raportet e Pranimit qe janë ne oferte me PTK te gjitha këto kane qene ne rregull.

Kompania NPN " Euro Projekt Plus" ka pasur kontrata per projekte dhe infrastrukturë me Komunën e Skenderajt me BP Home me Partneret tanë ne Konzercium kane pasur kontrata me PTK me Projekte Gjeodezike por nuk kane shikuar fare ofertën qe kjo shihet qarte qëllimi i eliminimit ka qene . Nëse nuk i kane pasur te qarte Kontrata dhe Referencat AK i KK Mitrovicës ne përputhje me nenin 72 te ligjit 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L 092 ka mundur te kërkoj plotësim dokumentet ne baze te listës se Referencave qe i kemi dorëzuar ne baze te cekurave me lart mundem me konstatuar se kane bere shkelje te rende te
nenit 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë po e citojmë: *Autoriteti kontraktues mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të këtij ligji.*

Autoriteti kontraktues i Kuvendit komunal te Mitrovicës ka bere -
shkelje te pikës 9.1 te dosjes se tenderit pasi ne si kompani i kemi plotësuar kriteret e kërkuar ne Dosjen e tenderit dhe ne njoftimin per Kontrate ku dhe vlerësimi i tenderit duhet te behet sipas këtyre kritereve te përcaktuar ne FTD dhe ne dosjen e tenderit. Arsyeja e eliminimit e dërguar nga AK mungon Licenca per Softver ne emër te kompanisë kjo nuk qëndron pasi ne si Kompani e kemi ne emrin tim dhe Unë jam pronare i Kompanisë "Euro Projekt Plus NPN" Xhemshir Mulliqi Can. Dr. Sc i Ndërtimtarisë ne Universitetin Shtetëror te Zagrebit licenca jane edhe te noterizuara. Gjithashtu ne beje projekte te ndërtimtarisë se larte qe janë me komplekse se projektet e Infrastrukturës tokësore kanalizime dhe ujësjellës.

Gjithashtu AK i KK Mitrovicës ka bere shkelje edhe te-
nenit 51 pasi nuk përputhen kërkesa per Sigurim te Ofertës është kërkuar 4500.00 euro ne Njoftimin per Kontrate ndërsa nuk është kërkuar ne Dosjen e tenderit kjo praktike është perdorur sa per ti Hezituar OE pra per ti futur ne lajthitje.

Ka bere shkelje te **nenit Neni 57 Sigurimi i Tenderit** -nëse autoriteti kontraktues

vendos një kërkesë për sigurimin e tenderit, kërkesa e tillë do të aplikohet për të gjithë tenderuesit. Autoriteti kontraktues do të refuzojë dhe nuk do të vlerësojë një tender të pranuar nga një tenderues që nuk e ka përmbushur kushtin e depozitimit të sigurisë së tenderit.

Gjithashtu ka bere shkelje te nenit 60 te LPP-se pasi nuk ka bere vlerësim real se kompania "Euro Projekt Plus NPN" ka qene me te lire edhe është ne kundërshtim edhe piken 31.1 e dosjes se tenderit:
Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më te ulët ☒ apo
Gjithashtu ka bere shkelje te nenit 60 pasi kriter i tenderit ka qene Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më te ulët dhe nëse e bëjmë një llogaritje mesatare është 150.000.00 euro ma lire kompania jone se e rekomanduara per kontrate.

Autoriteti kontraktues i Kuvendit komunal te Mitrovicës ka bere shkelje
te nenit 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale kompania "Euro Projekt Plus NPN" me Partneret ne konzercium i ka plotësuar kriteret e tenderit ndërsa Autoriteti Kontraktues duhet te vlerësoj se a i plotëson deshmit per kualifikime minimale duhet te hyje ne listën e ngushte e tani kompania qe është me çmimin me te lire duhet te rekomandohet me kontrate me ketë vlerësim ka bere shkelje te nenit 26. Pika 2 Kriteret e Përzgjedhjes.

Gjithashtu AK i KK Mitrovicës ka bere shkelje te nenit 68 Gjendja Ekonomike dhe Financiare pasi "Euro Projekt Plus NPN" me Partneret ne konzercium e ka përmbushur këtë kushte mirëpo per vitin 2016 kemi dorëzuar qarkullimet po tenderi ka qene i shpallur ne Tremujorin e pare e ne nuk kemi mundur te përfundojmë bilancin/auditimin pa përmbyllur te gjitha pagesat e vitit 2016.

Menaxheri i Prokurimit ka bere shkelje te rendet te nenit Neni 30 Nën-kontraktimi pasi ne njoftimin per dhënie te kontratës dhe ne dosjen e tenderit e ka cekur se nuk bene te nën-kontraktohet (shikoje njoftimin per kontrate) ky aktivitet i Prokurimit ndërsa OE i Rekomanduar me kontrate e ka marrëveshjen per nen-kontraktim qe kjo nuk lejohet me atë kriter te behet nen-kontraktimi. Gjithashtu Tenderuesi duhet të tregojë në tenderin e tij ndonjë pjesë të kontratës që ai ka për qëllim të nënkontraktojë palëve të treta dhe secilin nënkontraktues të propozuar. Ndërsa OE i rekomanduar per kontrate ne Formularin e tenderit pjesa C ne piken 6 duhet te ceke emrin e nënkontraktorit qe do te nënkontraktoje punët dhe sa përqindje te nenkontraktimit duhet te lejohen. AK i KK Mitrovice nuk ka jep kuruar vërejtje OE Infratekut NTSH qe është rekomanduar per kontrate.

Gjithashtu ky OE i Rekomanduar per kontrate nuk i ka plotësuar nenin 65 te LPP-se pasi nen-kontraktori nuk ju kane kërkuar kërkesat e pershtatshmeris ATK-ja dhe Gjykata . Ndërsa tashti mundet ti ket por pasi ne kemi shkuar ne qasje te dokumentave nuk ju kishin kërkuar dhe nuk i kishte pasur ne oferte personat pergjegjes thoshin se nen-kontraktori nuk ka nevojë ti dorëzoj. Mirëpo as i rekomanduari per kontratë nuk i kishte pasur ATK dhe Gjykatën dhe njoftimi per dhënie është publikuar KRRPP ne momentin kur ne kemi qene ne qasje te dokumente zyrtare nuk i ka pasur.

Ka bere shkelje te nenit 18. Dosja e Tenderit RRUOPP Pjesa C, Formulari për dorëzimin e ofertës, është pjesa kryesore e tenderit, sepse në këtë pjesë ofertuesi deklaron se ai ka kontrolluar dhe pranon të gjitha kushtet e tenderit dhe dorëzon ofertën e tij financiare. Ajo përbëhet nga: ¬ Formulari i tenderit ¬ Lista e çmimeve OE duhet të plotësoj dhe te

nënshkruaj formularin (dy pjesët), sepse në qoftë se formulari nuk është plotësuar kjo do të thotë se nuk ka ofertë.

AK i Kuvendit te Mitrovicës ka bere shkelje te nenit 18.13 AK do të deklaron gjithashtu në DT që OE-të duhet të tregojnë në tenderin e tyre çdo pjesë të kontratës që OE ka për qëllim të nënkontraktoj te palët e treta dhe secilin nënkontraktues të propozuar. Secili nen-kontraktor i propozuar duhet te përmbush kërkesat e përshtatshmërisë dhe duhet te dorëzoj dëshmitë mbi përmbushjen e kërkesave te përshtatshmërisë . Nenkontraktimi nuk bene te tejkaloje 40% te vlerës totale te kontratës. Autoritetet kontraktuese mund të sigurojnë, ku ata e konsiderojnë atë si të nevojshme, për pagesat direket për nënkontraktorët. Operatori ekonomik që shpërblehet me kontratë mbanë përgjegjësinë e plotë për përmbushjen e kontratës në pajtim me kontratën pavarësisht që ndonjë pjesë nënkontraktohet të palët e treta. Tenderuesi duhet të dorëzoj dëshmi në lidhje me përmbushjen e përshtatshmërisë së nënkontraktuesit për pjesëmarrje në procedurën e tenderit siç kërkohet në Nenin 65 të LPP-se. Operatori ekonomik duhet të njoftoj autoritetin kontraktues për çdo ndryshim në plane të nën-kontraktimit që ndodhin pas dorëzimit të tenderit. Autoriteti kontraktues mund të refuzoj çdo nënkontraktues të propozuar nëse i njëjti nuk i përmbush kushtet e përshtatshmërisë.

Është edhe ne kundërshtim me nenin 26. Kriteret e Përzgjedhjes RRUOPP. (Shikoni tabelën e kritereve)

Ka bere shkelje te nenit 39 te UDHËZUESI OPERATIV për PROKURIMIN PUBLIK 39. Sqarimi i Tenderëve.

Kane bere shkelje te nenit 41. Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve RRUOPP komisioni i vlerësimit kane shkelur shtate parimet e prokurimit
1. Tenderët duhet të plotësojnë substancialisht kërkesat formale administrative të specifikuara.
2. Tenderët duhet ët jenë të pranueshëm dhe duhet të përmbushin kërkesat minimale të kualifikimit (nëse janë përcaktuar).
3. Tenderët duhet të plotësojnë substancialisht kushtet obligative teknike të specifikuara. 4. Tenderët e përgjegjshëm do të vlerësohen në bazë të kritereve të specifikuara të dhënies së kontratës.
5. Vetëm kërkesat dhe kritere e dhënies së kontratës të specifikuara në njoftim për kontratë/dosje të tenderit mund të përdorën si bazë për vlerësim.
6. Asnjë negocim nuk duhet të ndodhë në mes të autoritetit kontraktues dhe tenderuesve gjatë procedurës së vlerësimit, përveç komunikimeve që janë autorizuar saktësisht nga nenet 34 dhe 35 te LPP.
7. Megjithatë, vetëm sqarim i tenderëve mund të ndodhë pa ndonjë ndryshim të kushteve materiale ose aspekte të tenderit, përveç atyre te lejuara me nenin 59 dhe 72 te LPP-se.

Kërkojmë nga OSHP-ja qe rasti te kthehet ne RI-VLERSIM pasi jemi kompania qe i plotësojmë kushtet e kërkuar ne dosjen e tenderit.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*